



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR KOMUNITETE

Procesverbal nga mbledhja e XII-të (dymbëdhjetë - mandati VII), e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 30 qershor 2023

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, ndërtesa e Komunës, dhe filloi në orën 14:15.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Xhafer Ademi Kryesues i Komitetit për Komunitete.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti dhe atë: znj.Qëndresë Hajrizi, z.Florent Hasani, z.Demokrat Hodolli, znj.Shkurte Sejdiu, znj.Sevdije Mustafa, z.Selver Rama, kurse munguan z.Arbnor Fazliu dhe znj.Naile Ahmeti,

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin z.Liman Zeqiri shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim-ZKKK, z.Fadil Babatinca përfaqësues nga Stacioni i Policisë në Podujevë.

Rendi i ditës

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen duke i përshëndetur të pranishmit dhe duke i'u dëshiruar punë të mbarë, ndër të tjera theksoi, thirrjen dhe materialin për këtë mbledhje besoj e keni marrë me kohë, lexon pikat e rendit të ditës dhe pyet nëse ndokush dëshiron fjalën rreth rendit të ditës, nëse jo e hedh në votim.

Njëzëri nga të pranishmit miratohet rendi i ditës sipas thirrjes së kësaj mbledhje.

1. Procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Komunitete e mbajtur më 31 maj 2023

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth këtij procesverbali, nëse jo atëherë e hedh në votim.

Njëzëri, pa vërejtje apo plotësim ndryshime miratohet procesverbali i Komitetit për Komunitete nga mbledhja e mbajtur më 31 maj 2023

2. Identifikimi i mundësive për punësimin sezonal të pjesëtarëve të Komuniteteve jo shumicë, përmes Zyrës së Punësimit; Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve; dhe Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, rreth kësaj pike ndër të tjera theksoi, punësimi është çështja më e ndjeshme dhe më e prekshme dhe kërkon angazhime maksimale dhe serioze nga të gjithë.

Duke parë gjendjen reale në shtetin tonë, me theks gjendjen e të pa punësuarve vend të veçantë për diskutim janë edhe komunitetet jo shumicë për të cilët duhet të angazhohemi të gjejmë forma dhe mënyra të punësimit. Në të kaluarën e kemi praktikuar që në bashkëpunim mes institucioneve qoftë lokale qoftë qendrore si dhe duke marrë për bazë statistikën dhe të dhënat e të pa punëve e që

normale se nuk janë të gjitha të sakte sepse të gjithë nuk lajmërohen si të tillë, madje unë kam marrë një evidencë aty ku janë vetëm 31 persona të pa punë nga radhët e komunitetit jo shumicë në Komunën e Podujevës, ndërsa realiteti është se është një numër shumë më i madh.

Po ashtu duke u bazuar nga gjendja ekonomike dhe sociale që janë komunitetit jo shumicë atëherë obligohemi të gjejmë forma dhe mënyra për të ardhë deri te një vend pune, andaj përmes kësaj forme që quhet praktikë sezonale, normale që Ministria e Punës dhe asaj për Mirëqenie Sociale në bashkëpunim me Entin e punësimit por edhe me Ministrinë tjera relevante që kanë koordinim kanë gjetë hapësirë sepse këto tema i kemi diskutuar në Zyrën e Kryeministrit në kuadër të të cilës është Zyra për komunitete si zyre e veçantë. Aty është theksuar dhe është bërë thirrje që të gjendjen format dhe mënyrat për punësim të komuniteteve jo shumicë. Ministria e Punës natyrisht se ka forma që aplikon për punësim sezonal, por edhe Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural përkatësisht Agjencioni Pyjor ka pas praktika të shumta ku kanë punësuar punëtor sezonal, kryesisht për pastrimin e pyjeve, lumenjve, ambientit dhe të ngjashme me një afat 3 deri në 6 muaj që paksa të zbutet papunësia në përgjithësi por natyrisht duke përfshirë edhe komunitetin jo shumicë.

Pra kjo pikë është mjaftë e rëndësishme dhe meqë ende jemi ende në fillimin e sezonit të kemi mundësi që këtë temë ta diskutojmë edhe në këtë Komitet edhe pse me organet përkatëse të Nivelit qendrorë e kemi diskutuar dhe kemi bërë kërkesë që të vazhdoj punësim sezonal dhe të ketë angazhim të shtuar për zbutjen e papunësisë, me theks tek komunitetet jo shumicë.

Në vazhdim foli për kontaktet me Zyrën për qeverisje të mirë pran Zyrës së kryeministrit, hartimet e planeve, raporteve dhe projekteve të ndryshme dhe çështjet tjera sa i përket papunësisë dhe brengave të nivelit lokale rreth kësaj çështje, për të cilën theksoi se të gjithë po kërkojnë një punësim që e cilësojnë më të sigurtë siç është administrata publike, nëpër shkolla apo edhe institucione shëndetësore edhe pse pothuajse të gjithë jemi në dijeni se sektori provat është shtylla kryesore e shtetit andaj edhe do të duhej të punohej në drejtim që kompanitë dhe bizneset e ndryshme private të gjejnë një marrëveshje me organet e sektorit privat që të mundësohet një koordinim më mirë sa i përket punësimit sezonal dhe jo vetëm.

Ne po e shohim trendin në ardhje dhe sigurisht se shumë shpejt do të vie koha kur nuk do të merremi më vetëm me peronat e riatdhesuar por të kemi punë edhe me perona nga jashtë që do të vijnë në Kosovë për të punuar qoftë punëtor sezonal qoftë edhe mënyra tjera të punësimit ngase ne po e shohim trendin e ikjes së rinisë së vendit në drejtim të shteteve europiane dhe më gjerë e me këtë rast Kosova do të jetë pa fuqi punëtore, pa trung intelektual dhe pa drejtime deficitare që i vyejnë këtij vendi për çka mund të them se është e dhimbshme kjo çështje mirëpo që do të duhej si shtet të kemi strategji dhe politika që t'i ndalim ata duke krijuar vende pune dhe zhvillim më të madh, duke mos përjashtuar edhe nivelin lokal që duhet të ketë politika dhe strategji të ndryshme për parandalimin e ikjes së të rinjve tanë duke zbutur papunësinë e cila mund të ndodh me ndonjë zhvillim ekonomik duke i dhënë përparësi edhe sektorit privat sepse sektori publik është më stërngarkuar. Janë disa kritere sa i përket çështjes së punësimit ku normale se duhet të jenë të barabartë të gjithë, andaj në kuadër të kësaj duhet gjetur forma dhe mënyra të punësimit sezonal qoftë ne si nivel lokal qoftë përmes nivelit qendrorë.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, falënderoj shefin e ZKKK-së për sqarimet dhe fjalën që e paraqiti. Ne si komunitete jo shumicë kemi interesim për punësim dhe atë kryesisht në sektorin privat dhe në këtë aspekt kanë konkuruar një numër i madh në kompani dhe biznese të ndryshme, me thek në maketet Viva dhe Interex e që 2 prej tyre janë punësuar në këto biznese, kështu që interesimi është i madh po mundësitë po janë më të vogla. Pavarësisht kësaj ne si

komunitete do të jemi të interesuar dhe do të bëjmë përpjekje të angazhohemi për punësimin e pjesëtarëve tanë sepse vërtetë interesimi është i madh.

Është e vërtetë ajo që e potencoj parafolësi shefi i ZKKK se në të kaluarën një numër i madh i komunitetit jo shumicë janë punësuar në punë sezonale qoftë në pastrim të pyjeve, lumenjve e të ngjashme e që ishte ndihmë shumë e madhe për ato familje, mirëpo tani punë të tilla nuk ka.

Urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e përfundojmë këtë pikë të rendit të ditës dhe kalojmë në pikën e radhës.

3. Sensibilizimi dhe mbështetja e nxënësve të Komuniteteve jo shumicë për regjistrim në Shkollat e Mesme të Larta, dhe në Studime për nxënësit që kanë përfunduar maturën, për regjistrim në fakultete.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, kjo çështje konsideroj se për neve komunitetet jo shumicë është sfidë mjaft e rëndësishme ngase nxënësit e komuniteteve jo shumicë po e përfundojnë shkollimin e mesëm mirëpo për shkaqe të kushteve ekonomike nuk mundën të regjistrohen në fakultete, edhe ata që regjistrohen po mbesin mbrapa sepse për shkaqe të kushteve herë pas herë po detyrohen t'i ndërpresin vijimet dhe po mbesin mbrapa.

Është për mirëseardhje që në shumicën e rasteve ata studentë po marrin bursa sikurse që marrin të gjithë nxënësit e shkollave të mesme nga radhët e komuniteteve jo shumicë në Komunën e Podujevës, kështu që neve na mbetet vetëm që të angazhohemi që përmes prindërve të tyre të kenë mbështetje në fusha të ndryshme në mënyrë që të vazhdojnë shkollimet e tyre sepse në rast se nuk po kanë mbështetje nga prindërit e tyre ata nxënës të tyre pastaj po mbesin pa shkollim.

Madje tani pata një diskutim me një prind nga radhët e komunitetit jo shumicë vajza e të cilit vitin e kaluar e ka përfunduar shkollimin e mesëm, tani këtë vit edhe vajza tjetër e ka përfunduar shkollimin e mesëm dhe gjatë bisedës më tha se e kam pritur që në këtë vit t'i dërgoj dy vajzat përnjëherë sepse kushtet ekonomike nuk ma mundësojnë ndryshe.

Pra për student tani për tani kemi probleme si komunitet jo shumicë, përndryshe për nxënës të niveleve tjera arsimore nuk kemi probleme qoftë me regjistrim qoftë aspekte tjera.

Pra e përsërisë se ne duhet çdoherë të kemi përpjekje dhe të angazhohemi për t'iu dhënë kurajo të rinjve për shkollim.

z.Demokrat Hodolli, theksoi, pyetje për Kryesuesin, a keni ndonjë ide apo plan konkret për këtë çështje sepse vetëm dhënia e kurajës nuk mjafton.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, ideja jonë është që t'iu mundësohet marrja e bursave nxënësve të komuniteteve jo shumicë në mënyrë që pastaj ata të kenë mundësi të vijojnë shkollimin qoftë të mesëm por kryesorja është për student. Madje ne i'u premtojmë atyre që të vazhdojnë shkollimin universitar sepse bursat do t'ju ndahen pastaj. Fjala është për universitetin shtetëror sepse për privat nuk i kanë kushtet ekonomike.

znj.Shkurte Sejdiu, theksoi, unë jam duke vijuar studimet në fakultetin publik dhe ja dalë disi, ndërsa kolegje private vërtetë është shumë shtrenjtë për standardin tonë.

znj.Sevdije Mustafa, theksoi, rast të tillë kam pasë unë personalisht sepse më është dashtë t'i ndërpres studimet shkaku që mu ndërpre marrëdhënia e punës, pra tash do ta përfundoja fakultetin

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, theksoi, nuk është rastësi që janë lidhë këto tema siç është punësimi, ekonomia dhe arsimiti, shtylla këto të cilat unë mendoj se janë kryesoret sepse nëse nuk ke një gjendje të mirë ekonomike nuk pastaj as zhvillim as asgjë.

Me të drejtë e shtroj pyetjen parafolësi zotëri Hodolli, ne duhet të kemi ide dhe institucioni duhet të angazhohet më shumë për t'i stimuluar më shumë ngase inkurajimi vërtetë është dhe nuk mungon, pra të ndihmohen me bursa dhe forma tjera për shkollim. Për shkollim të ultë është obligative kjo që të regjistrohen dhe të vijojnë shkollimin, madje ka edhe sanksione për prindërit dhe për këtë DKA duhet të merr masa për mos regjistrim eventual të fëmijëve të tyre neperë shkolla të ciklit të ulët e që tani kemi 195 nxënës në këtë cikël, pastaj kemi 16 nxënës në ciklin mesëm 14 prej tyre në ekonomik e që mua personalisht më ka lënë përshtypje në kuptimin emocional që është një zhvillim i mirë kur bëhet fjalë për gjininë femërore, qe 8 vite kemi 8 vajza, mirëpo sërish mund të themi se ka mund të jetë numri më i madh i nxënësve të komunitetit jo shumicë në shkolla të mesme, por për shkaqe ekonomike disa prej tyre nuk kanë mundur t'i vazhdojnë shkollimet në shkolla të mesme të larta e që nuk janë obligative.

Pra për të parandaluar këtë që e potencova duhet të kemi stimulime qoftë me bursa qoftë me forma dhe mënyra tjera duke mos përjashtuar edhe punësimin e tyre për t'i inkurajuar që vazhdojnë shkollimin qoftë të mesëm qoftë në fakultete, si dhe të bëhen hulumtime nëpër familjet e tyre sa i përket gjendjes ekonomike të tyre, të ardhurave të familjes dhe mundësive ë tyre për shkollim, ngase janë shkaktarët kryesor të mos vijimit të shkollimit nga ana e tyre edhe përkundër faktit që ata janë të zgjuar, kanë dëshirë dhe mund të arrijnë.

Unë e falënderoj z.Xhafer Ademin për bashkëpunim e gjatë që kemi në këtë çështje sepse përmes OJQ-së që ai është kryetar ne kemi ndihmuar shumë komunitetin jo shumicë me theks nxënësit qoftë në aspektin e rregullimit të dokumentacioneve për aplikim për bursa dhe çështje tjera me rëndësi. Kjo qasje pastaj shkon në mënyrë zingjirore varësisht nivelit të shkollimit por edhe shteti mandej duhet që përmes kriterëve dhe poentimeve të ndihmoj ata nxënës të komuniteteve jo shumicë që vijojnë shkollimin në universitete sepse të gjithë nuk mund të vazhdojnë këtë nivel të shkollimit.

Pra si temë është shumë me rëndësi dhe ndërlidhet me çështjen ekonomike por që duhet të kemi si fakt dhe të krijojmë opinion për të gjitha institucionet që të kenë informacione për këtë çështje në mënyrë që pastaj komunitetet jo shumicë të jenë më aktiv dhe t' inkurajohen t'i dërgojnë fëmijët e tyre nëpër shkolla.

Në kuadër të DKA-së është një komision i veçantë që merret me çështjen e braktisjes së nxënësve nëpër shkolla, pastaj ne bëjmë vizita sistematike nëpër shkolla ku shembull madje detyrohemi të vizitojmë edhe familje të ndryshme për të parë shkaqet dhe arsyet e ndaljes nga shkollimi siç ka qenë rasti i familjes Behluli e cila është në një gjendje shumë të rëndë ekonomike e që pastaj me DKA-në kemi biseduar që t'i ndihmohet asaj familjeje.

Institucionet lokale janë shumë të interesuara t'i ndihmojnë komunitetet jo shumicë dhe atë jo vetëm në aspektin e shkollimit, dhe përmes integritit të tyre si një diversiteti i shoqërisë zhvillohet edhe shoqëria dhe demokracia e lirë për të qenë të barabartë si një barazi që të gjithë e dëshirojmë.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, para rreth një jave kam pas një takim me kryesinë e shoqatës që kemi si dhe me kryesinë e partisë që kemi ku unë jam kryetar i të dyjave dhe kemi marrë një vendim të përbashkët që të shikohen mundësitë që nga diaspora e komunitetit jo shumicë të bëjmë një fond për studentët që vijojnë studimet në mënyrë që t'jua plotësojmë disa kushte për vijim të studimeve, kryesisht rrugëtimin dhe ushqimin duke mos përjashtuar edhe ndonjë bursë për ta sepse kemi vërejtur se nga Podujeva shumë pak kemi student të komuniteteve jo shumicë që ndjekin studimet kështu që ka lind nevoja e një iniciative të tillë, mirëpo sa do të na përkrahin mbetet të shihet sepse ende nuk kemi biseduar direkt me ata persona që jetojnë dhe punojnë

jashtë por që tani meqë është koha e pushimeve ne do të organizojmë një takim të përbashkët dhe do t'i diskutojmë këto ide.

Urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth kësaj teme, nëse jo atëherë e konstatojmë të përmbyllur këtë dhe kalojmë në pikën e radhës.

4. Të ndryshme

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, tani jemi në fazën kur bëhen regjistrimet e nxënësve në klasat e para dhe në parashkollor gjë që për neve është një pikë mjaft e rëndësishme sepse deri tani kemi pasë të funksionalizuara Qendrat e mësimit shtesë dhe me këtë çështje janë marrë më shumë mësuesit që kanë qenë nga radhët e komuniteteve jo shumicë, ndërsa tani ato qendra janë mbyllë dhe neve na mbetet të angazhohemi më shumë për regjistrimin e nxënësve në klasa të para dhe në parashkollor.

Ndoshta na duhet të mbledhim të dhëna dhe fillimisht ta bëjmë një evidentim të atyre fëmijëve që kanë për tu regjistruar në këtë vit e pastaj të marrim veprime konkrete për regjistrimin e tyre në mënyrë që të mos mbetet asnjë pa u regjistruar.

Niveli i vetëdijesimit të komuniteteve jo shumicë në Komunën e Podujevës është rritur shumë mirëpo vetëm kukëzohet edhe një angazhim shtesë i të gjithëve që të gjithëve për regjistrimin e atyre që kanë mbushë moshën në klasa të para dhe në parashkollor.

Për nivele tjera të shkollimit nuk kemi probleme si komunitete, madje nga paslufta të gjithë ata që kanë kryer shkollimin fillor të gjithë janë regjistruar në shkollimin e mesëm, përjashtim kam qenë 1 nxënës por që edhe atë pas një kohe e kemi regjistruar dhe ka vijuar shkollimin, kështu që gjithëherë jemi falënderues ndaj Komunës së Podujevës - Drejtorisë së Arsimit.

Pra jemi duke u angazhuar në këtë çështje dhe ju bëj thirrje të gjithë anëtarëve nga radhët e komuniteteve jo shumicë që jemi në këtë Komitet ta marrin si obligim këtë dhe t'i njoftojnë prindërit nëpër lagjet e tyre ku jetojnë, të bisedojnë me ta dhe t'i inkurajojnë për regjistrimin e fëmijëve të tyre me kohë në klasa të para dhe në parashkollor.

znj.Sevdije Mustafa, theksoi, vitin e kaluar kemi pas raste që nuk janë regjistruar me kohë dhe pastaj nuk ka pasë vende por që janë kthyer parashkollor dhe rrjedhimisht është humb 1 vit për ata fëmijë.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, për këtë unë ju bëra thirrje që ta merrni me këtë çështje në lagjet ku jetoni ju anëtarët e komuniteteve jo shumicë që jeni pjesë e këtij Komiteti. Gjithashtu unë i kam kontaktuar edhe lagjet tjera që nuk kanë përfaqësuesin e tyre në këtë Komitet dhe i kam obliguar që ta bëjnë një gjë të tillë, konkretisht që të bëjmë të pamundurën për regjistrimin me kohë të fëmijëve në klasa të para dhe në parashkollor.

znj.Sevdije Mustafa, theksoi, sa i përket lagjes ku unë jetoj të gjithë janë regjistruar me kohë dhe nuk kemi pas ndonjë telashe në këtë aspekt sepse i kam lajmëruar me kohë dhe i kam inkurajuar të regjistrohen, të vijojnë shkollimin dhe të mësojnë.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, është mirë që secili të bisedoj me prindërit dhe t'i bindin për regjistrimin e tyre në shkollim, nëse ka nevojë lirshëm mund të më kontaktoni dhe unë vijë edhe bisedojmë bashkërisht me ta, madje në këtë çështje mund të inkuadrohet edhe Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim e Komunës së Podujevës.

Po ashtu të bëhet përpjekje që të ketë identifikim të atyre nxënësve nëpër lagjet e juaja, qoftë të atyre që janë regjistruar në afatin e parë qoftë atyre që kanë mbetur pa u regjistruar në mënyrë që të angazhohemi që në afatin e dytë të regjistrohen.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, theksoi, në vitin e kaluar kemi pasë 10 nxënës të regjistruar në parashkollor.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, vlen të theksohet se shkollën e mesme ekonomike nxënësit e komuniteteve jo shumicë vitin e kaluar kanë marrë edhe mirënjohje, konkretisht nxënësja Tahire Ademi.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, theksoi, sa i përket asaj që Kryesuesi e ceku si iniciativë që kanë ndërmarrë për krijimin e një fondi nga bashkatdhetarët e juaj, mendoj se është një ide e mirë kjo sepse sa jam në dijeni unë ka një numër bukur të madh të komuniteteve jo shumicë që punojnë dhe veprojnë në shtete tjera. Pra vetëm kërkohet një iniciativë e tillë dhe një përkushtim paksa, por të kemi parasysh se iniciativa të tilla bëhen në të shumtën e rasteve përmes shoqatave joqeveritare, dhe këtë e them nga kureshtja dhe përvoja që kam që Shoqatën “Ali Ajeti” në Frankfurt të Gjermanisë e kam udhëhequr për 8 vite dhe në fushën së arsimit në kuadër të Shoqatës në atë kohë ka qenë Nexhmi Balaj i cili pastaj ka qenë edhe Drejtor i Drejtorisë së Kulturës Rinis dhe Sportit në Komunën e Podujevës, dhe i cili ka mbajtur listat e rreth 17 studentëve që i kemi financuar në Kosovë, prandaj e them këtë sepse si ide është shumë e mirë për të gjetur donatorë të tillë sepse ne jemi në dijeni se shteti duhet t’i financoj ata studentëve mirëpo po jemi në dijeni për gjendjen që jemi, por edhe donatorët e kanë rolin e vet dhe ndikojnë shumë pozitivisht tek financimi i studentëve. Pra vetëm kërkohet një iniciativë e tillë dhe jam i bindur se çdo njëri do të kontribuojë në këtë aspekt.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, edhe unë shpresoj dhe besoj se mërgimtarët tanë që jetojnë dhe veprojnë në shtetet të ndryshme do të japin përkrahje kësaj initiative dhe do të ndajnë nga një shumë për studentët e komuniteteve jo shumicë, mirëpo mbetet të shihet mënyrat dhe format tjera të organizimit që do të bëjmë.

Po ashtu një Organizatë jo Qeveritare është lajmëruar për t’i ndihmuar nxënësit të cilët kanë përfunduar klasën e nëntë dhe që kanë ndërprerë vijimin në klasën e dhjetë, unë i kam ofruar disa emra të atyre nxënësve dhe ata nxënës do të vijojnë shkollimin e tyre duke u mbështetur financiarisht nga ajo Shoqatë, dhe për këtë unë edhe kam vendosë lajmërimet nëpër lagjet ku jetojnë komuniteti jo shumicë në Komunën e Podujevës që kushdo që dëshiron mund të regjistrohet në atë Shoqatë dhe të vazhdoj tutje

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, theksoi, rreth kësaj që e ceku Kryesuesi jua rikujtoj se duhet të përcillet edhe konkursi për regjistrim sepse do të del një konkurs në bazë të të cilit edhe do të regjistrohen.

Meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesuesi i Komitetit e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 14:45

Procesverbalin e mbajti,

Enis Sheholli

Nr.prot.01-060/04-0044378/23

Podujevë, 30 qershor 2023

Kryesuesi i Komitetit

Xhafer Ademi